

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin financiar 2008

Versioni Përmbyllës

Prishtinë, 31 Gusht 2009

PËRMBAJTJA **Faqe**

1 Adresimi nga Auditori i Përgjithshëm 3

2 Përmbledhje 4

3 Opinionet e Auditimit mbi subjektet e audituara 11

Shtojca

1 Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400) 15

1 Adresimi i Auditorit të Përgjithshëm

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit,

Me këtë ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit në lidhje me implementimin e buxhetit Qeveritar të vitit 2008 dhe pasqyrën vjetore financiare të Qeverisë për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Kam kënaqësinë që t'ju prezantoj këtë raport brenda afatit të paraparë ligjor duke ju mundësuar që të përgjigjeni kur e gjeni kohën e përshtatshme në mënyrë që të shkarkoni zyrtarët përgjegjës prej përgjegjësive të tyre para se të sillni vendimin për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Ky raport është paksa ndryshe prej raportit i cili ju është dorëzuar gjatë viteve paraprake. Ne kemi ndarë raportimin tonë vjetor në:

(a) Raport Vjetor të Performancës (RVP), i dorëzuar më 30 Prill të këtij viti, ku përfshihet performanca dhe përgjegjësia jonë ndaj jush; dhe
(b) Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) ku përfshihen gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për vitin vijues financiar.

Kryesisht në këtë raport, Unë adresoj raportin e BKK-së të Qeverisë, por gjithashtu i ndërlidhi të gjeturat dhe konkluzionet e mia në lidhje me raportin e Progresit të Auditimit të Brendshëm dhe Prokurimit. Ju keni pranuar më herët raporte nga ana e Qeverise mbi këto çështje.

Më tutje i kam dhënë disa konkluzione të përgjithshme në lidhje me auditimin e kryer ndaj një institucioni i cili është jashtë buxhetit të BKK- së, RTK-ja, edhe për herë të parë kam rastin t'i paraqes rezultatet e dy auditimeve të kryera të performancës.

Unë shpresoj se kjo do të jetë një qasje e vlefshme dhe relevante për nevojat e juaja dhe pres të kem një shqyrtim të mëtejme lidhur me këtë raport.

Prishtinë, 31 Gusht 2009



Lars Lage Olofsson
Auditori i Përgjithshëm

2 Përmbledhje

Opinioni i Auditimit[1]

Opinioni im i përgjithshëm *për Pasqyrat Vjetore Financiare të Qeverisë për BKK 2008* është se në aspektin material ato janë:

- Në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe me Udhëzimet Administrative të zbatueshme;
- Në pajtim me SNKSP; dhe
- *Paraqesin pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të BKK-së.*

Kështu që ky është një "*Opinion i pakualifikuar*" në harmoni me Standardet ndërkombëtarisht të pranuara të Auditimit nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 400 cf. Shtojca 1).

Auditimet individuale të Organizatave Buxhetore kanë përbërë një bazë të dhënies së opinionit tonë për BKK-në. Ne kemi audituar 23 prej tyre, të cilat në tërësi përbëjnë 95% të të hyrave dhe 80% të shpenzimeve.

Auditimi i *PVF të Shpenzuesve individual Buxhetor* ka dhënë opinionet si më poshtë:

- Tri Opinione të Pakualifikuara;
- Gjashtëmbëdhjetë Opinione të Pakualifikuara me Theksim të Çështjes; dhe
- Katër Opinione të Kualifikuara.

Sidoqoftë, ekzistojnë disa mangësi *në procesin e përpilimit të Pasqyrave të Konsoliduara, e që kryesisht janë*:

- Disa Organizata Buxhetore nuk kanë dorëzuar kontributet e tyre në PVF me kohë apo nuk i kanë dorëzuar fare;
- Organizatat tjera Buxhetore kanë regjistra jo të plotë kontabël dhe Pasqyrat Financiare përgatiten duke përdorur Evidencat e Thesarit;
- Ekzistojnë prezantime të mangëta të pasurive sa i përket vlerës së tyre financiare apo në disa raste edhe ekzistimit të tyre. Shpalosja e tyre në pasqyra financiare (në Shtojcën 6) është e kërkuar. Megjithatë, pasi që ato nuk ndikojnë në ndonjërën prej tri pasqyrave atëherë vetvetiu nuk iu është dhënë Opinioni i Kualifikuar për Shpenzuesin Buxhetor në fjalë. Në vend të kësaj ne kemi dhënë Opinion të Pakualifikuar me Theksim të Çështjes;
- Duhet të fuqizohen barazimet e përgjithshme;
- Ekzistojnë disa komuna të cilat kanë mbetur prapa sa i përket trajtimit kontabël të të hyrave vetjake gjë e cila mund të rrisë rrezikun për parregullsi; dhe
- Barazimet e ndryshme që janë bërë nga ZAP, me qasje analitike, për të verifikuar korrektësinë e tri Pasqyrave Financiare nuk kanë rezultuar me mospërputhje tjera materiale. Fondi i AKM dhe AKP është prezantuar si pjesë e BKK-së dhe si e tillë është edhe e barazuar nga ne.

[1] Versioni përmbyllës i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) – Raporti Vjetor për Vitin Financiar 2008 është version përmbyllës i raportit të plotë i cili është në dispozicion në Gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze në faqen zyrtare të ZAP. **www.ks-gov.net/oag**

Realizimi i buxhetit

Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve është i shpeshtë. Arsyeja kryesore duket të jetë:

- Mungesa e të kuptuarit të përgjegjësive themelore nga menaxhmenti;
- Mungesa e të kuptuarit më të thellë të dizajnit dhe qëllimit themelor të sistemeve të MFPP-së;
- Mungesa e *njohurive themelore të kontabilitetit*, dhe
- Harmonizim i mangët i urdhëresave me ligje dhe rregullore.

Duket se ka nevojë për udhëzues, shembuj të mirë dhe forma tjera të përkrahjes në këto gjëra. Unë mendoj se Njësia Qendrore Harmonizuese për dhe Kontroll dhe Menaxhim Financiar (NJQH/KMF) do të analizojë më tutje këto mungesa dhe do t'i prioritizojë masat që do të ndërmerren.

Dëshiroj po ashtu të tërheq vëmendjen tuaj tek disa çështje të veçanta shqetësuese:

- Niveli i ulët i implementimit të buxhetit i ndarjes përfundimtare (81%) tregon se organizatat buxhetore duhet të përmirësojnë planifikimin, ekzekutimin dhe përcjelljen pasuese të buxhetit;
- Niveli i lartë i shpenzimeve kah fundi i vitit bëhet për të kompensuar këtë në mënyra të rastësishme dhe joefektive (23,4% prej totalit të Mallrave dhe Shërbimeve dhe 38,7% të Shpenzimeve Kapitale në muajin Dhjetor);

Edhe pas përmbylljes të datës së pagesave të paraparë me Udhëzim Administrativ, janë kryer një numër i pagesave.

- Mungesa e një ligji për pagat dhe mëditjet në kombinim me procedurat e shkruara për ekzekutimin e pagave kanë rezultuar me një gjendje ku kemi Udhëzimin Administrativ mirëpo nuk ndiqet në mënyrë efektive.
- Trajtimi i pasurive jo financiare në shumicën e Organizatave Buxhetore nuk është në nivel me standardet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 2005/11 për Regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive qeveritare. Progresi gjatë viteve të fundit ka qenë i ngadalshëm. Ndoshta për shkak se udhëzimi nuk është kuptuar mirë ose nuk i është kushtuar kujdes i plotë nga niveli qendror; dhe
- Trajtimi i prokurimeve në shumicën e Organizatave Buxhetore ende lë vend për përmirësime substanciale.

Prokurimi

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) dhe Qeveria kanë bërë një vlerësim vjetor të operimeve dhe progresit të arritur në Prokurim Publik. Në këtë raport nuk analizohet ose prezantohet ndonjë mungesë e madhe e sistemeve – përveç në mënyrë indirekte përmes dhënies së rekomandimeve për thjeshtësimin dhe përvijimin e sistemeve.

Bazuar në auditimin tonë dhe Raportin Vjetor të KRPP-së, *unë i rekomandoj* Kuvendit ti adresojë Qeverisë/KRPP-së që të:

- Zhvillojnë procesin e vlerësimit strategjik të rrezikut i cili ofron siguri të arsyeshme për ekzaminimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të prokurimit;

- Standarizojnë dhe përforcojnë monitorimin dhe përcjelljen e aktiviteteve të prokurimit, përfshirë këtu veprimet që kanë për synim të ndihmojnë në sigurimin e implementimit të rekomandimeve të agjencive mbikëqyrëse dhe që zyrtarët të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre;
- Përforcojnë pjesët analitike të Raportit Analitik të KRPP-së; dhe
- Në nivel të KRPP-së të krijojmë Sistemin me Listën e Furnitorëve të Aprovuar për të siguruar që pranohen vetëm operatorët e kualifikuar ekonomik.

Kontrolli i Brendshëm

Rezultatet e auditimeve tona tregojnë probleme në implementimin e duhur të Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm. Duket se për këtë ka arsye të shumta. Siç është cekur edhe më herët, ka ende mungesë të të kuptuarit të koncepteve bazë të sistemit. Një shpjegim për këtë janë mospërputhjet në kornizën ligjore. Ka nevojë për udhëzime më të mira dhe shembuj për atë se si duhet dhe mund të kryhen gjërat. Ekzistimi i politikave/rregulloreve të brendshme që mungojnë do të ndihmonin në përmirësimin e sistemeve të gjithmbarshme.

Sistemi i kontrollit të brendshëm deri më sot ka funksionuar pa një komponentë të rëndësishme – NjQH/KMF. Synimi i NjQH/KMF është të sigurojë funksionimin e sistemeve të mira për menaxhim financiar duke futur në përdorim praktika të mira në mënyra më të përshtatshme.

NJQH/MKF tani është krijuar dhe MEF aktualisht është në proces të rekrutimit të stafit.

Konkludimi kryesor i mbështetur edhe nga auditimet tona është që NjQH/KMF duhet të rrënjoset në përkufizimin e gjerë të kontrollit të brendshëm – bazuar në përkufizimet e dhëna në Politikën për KBFP (Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik) e vitit 2007 – që të jetë në gjendje të adresojë sfidat e përballura.

Rekomandimi im është që të merret parasysh një zgjedhje e cila ka në vete një qasje më të gjerë, që përkrahë menaxherët për menaxhim të përgjithshëm financiar, bazohet në rezultatet përfundimtare të raportimit dhe rezultatet e operacioneve dhe formave tjera të raportimit që parashihen me Ligjin e ndryshuar për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Futja në përdorim e një fjalori të përbashkët për fushën e Menaxhimit të Financave Publike do ta bënte procesin e ligjbërjes më transparent, e në këtë mënyrë duke ofruar parakushte më të mira për implementuesit e ligjeve. Njëkohësisht, projektet e ndryshme të donatorëve në kuadër të administratës do të kenë bazë të unifikuar për ambiciet e tyre për përkrahje.

Decentralizimi (delegimi i përgjegjësive) në sistemin e pagesave është në proces e sipër. Pas certifikimit nga MEF, Organizatave Buxhetore do t'u besohet e drejta për autorizimin e pagesave të tyre. Megjithatë *rekomandimi im* është që delegimi i tillë i përgjithshëm duhet të bëhet pas një periudhe të gjatë provuese ku Thesari do të ketë mundësinë e krijimit të një pasqyre të saktë të aftësive të Shpenzuesve Buxhetor të sigurojnë interesin për një ekzekutim të duhur të buxhetit.

Auditimi i brendshëm

Në pranverë të vitit 2009, Kuvendit i është dorëzuar raporti i parë zyrtar qeveritar i përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQH/AB) në MEF në lidhje me Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2008.

Konkludimi kryesor i dhënë në atë raport ishte se Auditimi i Brendshëm nuk është plotësisht funksional në organizata buxhetore dhe se pritjet e menaxhmentit janë ende të nivelit të pa mjaftueshëm.

Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm nga ZAP-i

Auditimi i Brendshëm gjendet në fazën e hershme të zhvillimit. Funksioni i tij është fuqizimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm të menaxhimit financiar publik përkundër mangësive të shumta në kontrolin e brendshëm në menaxhimin e financave publike.

Ekziston një keqkuptim me shtrirje të gjerë se auditimi i brendshëm do të kujdeset për shumicën e sfidave në menaxhim financiar. Përqëndrimi parësor deri më sot ishte ndërtimi i kompetencave në auditim të brendshëm. Planet e prodhuara të auditimit të brendshëm në të shumtën e rasteve janë të shtjelluara në masë të pamjaftueshme jo mjaft mirë të fokusuara. Auditimet në praktikë ende përqëndrohen në transaksionet individuale dhe në pajtueshmëri. Ka shumë pak qasje të orientuar në sisteme, të ndërtuara në bazë të analizave në fushat me nivel më të lartë të materialitetit që përmbajnë rreziqe domethënëse. Si rrjedhim, auditimit të brendshëm ende i nevojitet të dëshmojë dobinë për menaxherët në pikëpamje më strategjike menaxheriale.

Si rrjedhojë, nuk jemi në gjendje të mbështetemi në aktivitetet e NjAB për sigurimin tonë audituesë në lidhje me Sistemet e Kontrollit të Brendshëm dhe aplikimit të tyre;

Po ashtu vërehet se themelimi i Komisioneve të Auditimit (KA) ka mbetur mbrapa. Duket se ekziston një ndjenjë në rritje se themelimi i një KA për cdo organizatë buxhetore mund të jetë i pamjaftueshëm dhe shumë i shtrenjtë.

Rekomandimi i im për Kuvendin është:

- Që në mënyrë aktive të ndjekë nga afër këtë instrument boshtor të implementimit të Ligjit për MFPP dhe të aranzhojë dëgjime me MEF-in dhe Kuvendin; dhe
- Në ndryshimin e Ligjit për Auditim të Brendshëm të sigurojë konsistencë me ligjet tjera në fushën e Menaxhimit dhe Kontrollit Financiar dhe të sigurojë një kornizë ligjore fleksibile dhe me kosto efektive.

Të gjeturat tjera të përgjithshme

Unë dëshirojë që t'ju tërheq vëmendjen në disa çështje specifike dhe të rekomandojë:

- Joefektshmëritë në Administrimin e Personelit duhet të rregullohen në mënyrë urgjente:
  - MEF duhet të theksojë rëndësinë e barazimit solid me ata që janë përgjegjës;
  - MAP duhet të shtrëngojë procesin rutinor për Kontratat për Paga;

- MAP duhet të përforcojë procedurat e saj për ekzekutimin dhe monitorimin e pagesës së rrogave;
- Procesi i ristrukturimit të përgjegjësive dhe mbyllja e institucioneve duhet të rishqyrtohet për të siguruar pasuritë publike dhe vlerat. *Unë sugjeroj* që të shtjellohet një Udhëzues i Përgjithshëm për administrimin, kontabilitetin dhe raportimin e këtyre çështjeve;
- NjQH/KMF t'i jepet detyrë për zhvillimin dhe krijimin e një terminologjie për KMF, me qëllim të sigurimit të konsistencës në ligje, rregullore dhe të sigurohet një kuptim i plotë i tyre; dhe

- Ende janë shqetësuese ndërmarrja e veprimeve për të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit. Unë nuk jam i kënaqur me progresin e deritashëm të Organizatave Buxhetore në adresimin e rekomandimeve tona dhe kjo duhet të adresohet në të gjitha nivelet e llogaridhënies. Kuvendi duhet të theksoj rëndësinë e veprimeve më efektive që duhet të ndërmerren nga ekzekutivi në lidhje me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit nga ZAP. Në mënyrë urgjente duhet të kërkohet nga Qeveria të përforcojë proceset e tyre rutinore në lidhje me këto gjëra.

Përmes prodhimit të raportit me kohë, respektimit të afateve, ne jemi duke shtuar vlerë me rolin tonë ligjor dhe me auditimet e kryera.

Auditimi i Performancës

Gjatë këtij viti, ZAP ka raportuar për herë të parë për Auditim të Performancës i cili është fokusuar në efektivitet, efikasitet, ekonomi dhe besueshmëri, kryesisht në (1) sistem për *Pensionet e Personave me aftësi të kufizuara* dhe (2) *Sistemi për Shpërndarjen e medikamenteve esenciale.* Që të dyja auditimet kanë shpalosur mangësi në lidhje me menaxhimin e sistemeve dhe kanë nevojë për përmirësime substanciale në ofrimin e shërbimeve respektove *me një kosto të efektshme* , me kohë dhe me kualitet të kërkuar. Disa vëzhgime nga raportet mund të ilustrojnë llojin e të gjeturës. Për *Pensionet e Personave me aftësi të kufizuara*: (a) si mesatare, afat për procedim të pensionit për persona me aftësi të kufizuar është 149 ditë në vend të kërkesës ligjore që është, më pak se 90 ditë; 9b) Kontroll i pamjaftueshëm në futjen e të dhënave mbi pranueshmërinë si dhe ndarje të pa mjaftueshme të detyrave tek stafi. Për *Shpërndarjen e Medikamenteve esenciale*; (a) farmacitë nuk marrin sasitë e porositura dhe të nevojshme të medikamenteve esenciale për shkak të sasive të pakta në Depon Qendrore: (b) nuk ka inventarizim periodik të medikamenteve: (c) kontrolle të pamjaftueshme për shpërndarje fizike të medikamenteve për pacientët që ngrit rrezikun për treg të dytë të paligjshëm.

Kontrolli menaxherial i proceseve nuk ka siguruar një bazë për përmirësime të nevojshme dhe një zhvillim të shërbimit. Menaxherët Përgjegjës duhet që të iniciojnë analiza më të detajizuara për sistem për të cilat janë vetë përgjegjës. Ata kanë nevojë të identifikojnë faktorët kritik dhe proceset për implementimin e shërbimeve në fushat kryesore me rrezik më të madh për shërbime të këqija dhe jo-efikasitet. Duhet të ndërmerren masa për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në vazhdim dhe zhvillimin e mjeteve dhe metodave në kuadër të tyre.

Auditimi i Shërbimit Publik (RTK)

Auditimi ynë mbi Radio Televizionin e Kosovës (RTK-në) ka shpalosur një numër të sfidave për këtë institucion. Shërbimi Publik paraqet një veçori të domosdoshme në të

gjitha demokracitë. Bazuar në konkluzionet tona dhe rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit, Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:

- Emërimin e Bordit të ri;
- Sqarimin e kërkesave raportuese në me të Bordit dhe Kuvendit duke siguruar pasqyra të plotë financiare akrruale në kuadër Raportit Vjetor, dhe si rrjedhojë marrjen e informatave më të mira mbi pozitën financiare të RTK-së;
- Si pasojë zgjerimin e mandatin e ZAP për të mbuluar auditimin e Raportit Vjetor të paraparë me Ligjin, përfshirë Pasqyrat e Plota vjetore Financiare, dhe si rrjedhojë marrjen informatave më të mira për auditim mbi rezultatet faktike financiare dhe rezultatet operative të RTK-së;
- Sqarimin e mospërputhjeve në kornizën ligjore; dhe
- Që ti jep RTK-së mundësinë për të veproj në tregun mediatik në atë mënyrë që institucioni të krijoj shërbimet e tij në mënyrë të suksesshme si dhe të jetë konkurrues, që mbi të gjitha nënkupton zgjidhje të qëndrueshme financiare dhe sqarimet që ndërlidhen me zbatueshmërinë e Ligjit mbi Prokurimit në Organizatat Jo-Buxhetore. Si pikënisje në adresimin e kësaj duhet të jenë standardet Evropiane të nxjerra nga Unioni Evropian i Transmetuesve.

Rekomandimet mbi Shqyrtimin e Jashtëm nga Kuvendi

Rekomandoj Kuvendin që të përmbyll zinxhirin e përgjegjësisë në përputhshmëri me qëllimet e LMFPP. Sipas pikëpamjes sime është shumë me rëndësi që Kuvendi të adresoj këtë sfidë dhe që ne vjeshtë të shpenzoj kohë të mjaftueshme për të diskutuar , marrë veprime dhe të vendos në lidhje me raportet nga Qeveria dhe AP. Zgjidhja më e përshtatshme sot në Evropë është aplikimi i sistemit me "seanca dëgjimore" , në prezencë të AP-së dhe Organizatave Buxhetore , për RVA të AP-së nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për mbajtjen e përgjegjësve për llogaridhënie . Si pikë minimale unë *rekomandoj* që Organizatat Buxhetore me Opinion të Kualifikuar ose të Kundërt të Auditimit të japin llogari.

Për më tej, do të forcoj transparencën e procesit të llogaridhënies nëse pikë qëndrimet e Kuvendit për këto çështje formulohen si Direktiva për Qeverinë , një rast , i cili zakonisht është përdorur në Evropë , për përcjelljen e këtyre Direktivave do të ishte ajo që Qeveria do të obligohej ti raportonte përsëri Kuvendit për veprimet e ndërmarra për sa i takon rekomandimeve të AP-së dhe Direktivave të Kuvendit . Një kornizë e përshtatshme kohore për këtë do të mund të ishte fundi i muajit Mars .

Po ashtu *rekomandoj* që Kuvendi të bëjë të zakonshme thirrjen e AP-së që ai ti prezentoj Raportet e Auditimit të Performancës, kur ato publikohen , atyre në prezencë të palëve që kanë interes të drejtpërdrejt. Kjo do të theksonte rëndësinë e auditimit të ri të performancës, do të jepte një "feedback" me vlerë mbi atë se si punojnë zotimet publike, theksimin e përgjegjësisë së performancës dhe rritjen e gjasave që të ndërmerren veprime adekuate në lidhje me të gjeturat dhe rekomandimet e ZAP.

Komentet e Qeverisë për RVA

Në pajtim me praktikat e mira Evropiane, kam kërkuar komentet e Qeverisë për RVA-në në mënyrë të vazhdueshme për editimin përfundimtar. Ministri i Ekonomisë dhe Financave

(MEF) me datën 17-08-2009 ka dhënë komentet përfundimtare të tij dhe të Qeverisë si vijon :

"Ne e kemi pranuar draft raportin e auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare të Qeverisë së Kosovës për vitin 2008. Me kënaqësi e kemi pranuar opinionin e pakualifikuar dhe vlerësimin pozitiv të pasqyrave financiare në të gjitha aspektet materiale.

Një pjesë e çështjeve të përmendura në raport, janë adresuar në ndërkohë nga Qeveria/MEF si pjesë e procesit të vazhdueshëm të përmirësimit të sistemeve dhe proceseve. *Ne e mbështesim tërësisht pjesën më të madhe të rekomandimeve dhe duhet të ndërmarrim hapa për të adresuar këto mangësi* në mënyrë që të sigurohet menaxhimi efikas dhe i duhur i parasë publike. Duke qenë se rekomandimet i drejtohen Kuvendit të Kosovës, ne do të jemi të gatshëm për të iu përgjigjur të gjitha kërkesave për adresim të çështjeve të cilat do të vijnë nga ky Institucion."

Komentet në *Shkresë* janë më tepër të natyrës teknike dhe janë adresuar gjatë fazës finalizuese të këtij raporti.

Si rrjedhojë, unë falënderoj MEF-in për komentet e tyre dhe vij në përfundim që ne kemi një mendimin të përbashkët mbi të gjitha faktet materiale të prezantuara në versionin final. Gjithashtu, duket se ne kemi një konsensus bazë se si ti adresojmë problemet e paraqitura.

3 Opinionet e Auditimit mbi subjektet e audituara

Subjektet e Audituara	Buxheti në Mil. Euro	Llojet e Opinioneve	Mungesat Menaxheriale
Ministria e Shëndetësisë	61,5	I pakualifikuar	Të hyrat nuk janë të besueshme në dokumentet burimore; Mos-harmonizim me Ligjet për Prokurim; menaxhim i dobët i pasurive fikse; kontroll i dobët i brendshëm;
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	82,5	I pakualifikuar	Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; menaxhim i dobët i pasurive; shmangia e tatimeve; subvencionet; dobësi në sistemin SIGTAS, kontroll i dobët i brendshëm
Doganat e Kosovës (DK)	8,9	I pakualifikuar	Mangësi në kontrollin e brendshëm; monitorim i pamjaftueshëm i Depove Doganore; Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim
Kuvendi i Kosovës	7,7	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin e Prokurimit, menaxhim i dobët i pasurive, detyrime të pashlyera
Zyra e Presidentit	1.2	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); menaxhim i dobët i pasurive; kontroll i dobët i Brendshëm
Zyra e Kryeministrit	4,0	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Mosharmonizim i të hyrave; Dobësi në menaxhimin e aseteve; Dobësi në kontrollin ë brendshëm
Ministria e Shërbimeve Publike	16,7	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Sistemi i kontrollit dhe auditimi i brendshëm; Pagat dhe Mëditjet; Mos-harmonizim me Ligjin e Prokurimit; menaxhim i dobët i pasurive;
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	62,5	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; menaxhimi i pasurive fikse; Kontratat në vepër në kundërshtim me Rregulloret e

			Thesarit; Të hyrat.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	4,0	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Menaxhim i Dobët i Pasurive Fikse; Mos-harmonizim me Ligjin e Prokurimit; kontroll i dobët i brendshëm;
Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	126,9	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; Nivel i ulët i të hyrave për lidhje me rrugën kryesore; menaxhimi i pasurive; kontroll i dobët i brendshëm;
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	146,4	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Menaxhim i dobët i pasurive fikse; Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; Dështim sa i përket bazës ligjore për skemën pensionale, asistencës sociale dhe subvencioneve për OJQ-të
Ministria për Komunitete dhe Kthim	6,3	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; subvencionet , kontroll i dobët i brendshëm; menaxhimi i pasurive fikse;
Ministria e Punëve të Brendshme	11,1	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; kontroll i dobët i brendshëm; menaxhim i dobët i pasurive fikse;
Ministria e Drejtësisë	15,3	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-barazim i evidencave të Thesarit me PF-të. prezantim i pasaktë i të hyrave; Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; menaxhimi i pasurive; kontroll i dobët i brendshëm.
Agjencia Kosovare e Privatizimit	3,4	I pakualifikuar me theksim të çështjes	PF jo të kompletuara në pjesën veriore të Trepçës; Mosharmonizim me Ligjin për Prokurim; APK ka paguar detyrime të pashlyera të AKM-së. Menaxhim i dobët i pasurive; kontroll i dobët i brendshëm; gjatë vitit 2008 nuk ka patur njësi

			të auditimit.
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit	48,3	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Mos-harmonizim në mes të të dhënave të Thesarit dhe PF, Detyrime të papaguara, Dobësi në dhënien e Subvencioneve.
Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)	9,9	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Mos-prezantimi i pasurive fikse në PF; mosbarazimi i të hyrave në evidencat e KGJK-së me evidencat e Thesarit; Mos-harmonizimi me Ligjin e Prokurimit; kontroll i dobët i brendshëm; mo-sprezantimi i depozitave në PF.
Shërbimi Policor i Kosovës	58,3	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; menaxhim i dobët i pasurive; Pagat e papaguara për punonjësit e pezulluar;
Komuna e Prishtinës	34,4	I pakualifikuar me theksim të çështjes	Mosprezantimi i pasurive fikse në PF; mosharmonizimi i të hyrave në evidencat e Komunës me evidencat e Drejtorive qe inkasojnë te hyrat; Mos-harmonizimi me Ligjin e Prokurimit;; Dobësi në dhënien e Subvencioneve.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	10,5	I kualifikuar	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mos-harmonizim me Ligjin për Prokurim; Pagat; Të hyrat nuk depozitohen në llogaritë e Thesarit; menaxhimi i pasurive; detyrime të pashlyera; subvencione; dështimi në mbylljen e avanseve; kontroll i dobët i brendshëm
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	4,7	I kualifikuar	Mosprezantimi i Pasurive fikse (UA 2008/13). Të hyrat; Mosharmonizim me Ligjin për Prokurim; pagat, auditim i brendshëm; menaxhim i dobët i pasurive fikse;
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	9.3	I kualifikuar	Shpalosje jo adekuate e aseteve fikse (UA 2008/13); Mungesë e evidencave kontabël për të hyrat dhe mangësi në një projekt të madh kadastral që ndikon në pasqyra financiare. Mungesë në menaxhimin e financave në

			përgjithësi, mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Zyra e Koordinatorit të - Trupave Mbrojtëse të Kosovës	18,0	I kualifikuar	Mos-Shpalosje e aseteve fikse (UA 2008/13); Menaxhim i dobët i pasurive fikse, kontroll i dobët i brendshëm Mungesë e dokumenteve mbi shpenzimet ë derivateve; mungesa e PF të nevojshme për gjysmën e parë të vitit 2009.
Gjithsej	**751,8**		**3 të pakualifikuar, 16 të pakualifikuar me theksim të çështjes dhe 4 me opinion të kualifikuar**

Shtojca

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2008

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:
(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuara të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve**. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund **të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:
(a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustifikuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
(c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i

paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinioni që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.